



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 12, datë 22. 02. 2022

**“PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË Nr. 25 DATË  
18.06.2004 , ”PER EMËRTIMIN E DISA RRUGËVE TË QYTETIT ÇOROVODË” I  
NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 22. 02.2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; neni 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, nënpika 1.7, gërma “b”, nenit 54, gërma “ll”, Ligjin Nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, neni 3

**VENDOSI:**

1. Listës së Vendimit të Këshillit të Bashkisë Skrapar Nr. 25, datë 18.06.2004 “ Për emërtimin e rrugëve të Qytetit Çorovodë , i ndryshuar ti shtohet emertimi: “Albert Zylfo”, rrugës nga ura në qendër të qytetit deri tek hyrja për në shkollën 9- vjeçare “Kahreman Ylli” Çorovodë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Bashkia Skrapar.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".

Vendimi u miratua me 9 vota pro , votë kundër – s’ka, vota abstenim - s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**  
**Edlira SHKËMBI**

